



## NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

### **PRN060 Organizata Punuese për Prodhimin dhe Qarkullimin (Shfaqjen - Distribuimin) e Filmave "Kosova Filmi"**

1969, 1973, 1974 OP për prodhimin dhe distribuimin e filmave "Kosova Filmi" në Prishtinë;  
1977, Organizata e Punës së Bashkuar për prodhimin dhe qarkullimin e Filmave "Kosova Filmi" i datës  
26.12.1977;  
1978, 1990, 1992, Organizata Punuese për prodhim dhe qarkullimin e filmave "Kosova Filmi" Prishtinë;  
1993, Ndërmarrja (sipas emërimit të masave të dhunshme) "Kosova Filmi" nga Prishtina në  
kuadër të Radiotelevizionit të Serbisë; 2000, UNMIK K.P.P.C. KOSOVA FILMI

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 18 janar 2021 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 22 dhjetor 2020.

**Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 29 janar 2021 dhe përfundon me datë 15 mars 2021 në orën 16:00.**

**Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.**

**Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.**

**Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Prishtinë**

**Rr. Rexhep Mala Nr. 2 (afër Ambasadës Sllovene),**

**10 000 Prishtinë,**

**Telefoni: +383 (38) 226 889**

**Fax: +383 (38) 227 100**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni "**Formularët-Udhëzime për plotësim**". Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.